



KOLEGJI DARDANIA

DORACAKU PËR STUDENTË

Ky doracak ju shërben studentëve që të njoftohen me veprimtaritë dhe shërbimet që ofron Kolegji Dardania

Prishtinë, Shtator 2025

KOLEGJI DARDANIA



DORACAKU PËR STUDENTË

*Ky doracak ju shërben studentëve që të njohohen me veprimtaritë dhe shërbimet që ofron
Kolegji Dardania*

Prishtinë, Shtator 2025

PARATHËNIE

Doracaku për studentë është një përmbledhje e përzgjedhur e paragrafeve nga Statuti dhe Rregulloret e Kolegjit Dardania në Prishtinë, të cilat rregullojnë statusin e studentit si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tij.

Doracaku ofron informacione për studentët gjatë tërë ciklit të studimeve, duke filluar nga procedurat sensibilizuese, aderimi, pranimi, procesi i studimeve, diplomimi dhe format e arsimimit të alumnëve në shërbim. Kjo bëhet me qëllim që të interesuarit, veçanërisht studentët, të kenë informacione të mjaftueshme rreth veprimtarisë së kolegjit dhe të kenë një adresë të saktë për adresimin e interesimeve të tyre.

Në doracak përfshihen paragrafë të përzgjedhur nga aktet ligjore dhe nënligjore të lëshuara nga MASHT-i, si dhe pjesë nga Manuali i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. Këto materiale shërbejnë për të informuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të interesuarit për pranimin e shërbimeve të Kolegjit.

PËRMBAJTJA

FJALA E REKTORES	4
LOKACIONI I KOLEGJIT DARDANIA	5
HISTORIKU	6
VIZIONI	7
MISIONI	7
OBJEKTIVAT	7
STUDIMET NË KOLEGJIN DARDANIA	9
I.VIJUESHMËRIA E STUDIMEVE	10
1.1 Plani dhe programi mësimor	10
1.2 Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik të studentit	12
Provimet nga Kolegji Dardania mund të organizohen:	13
Studenti humb statutin e studentit:	14
II. PROGRESI AKADEMIK	15
2.1 Bursa dhe mbështetje financiare për studentë	15
III. PROCEDURAT E DIPLOMIMIT PËR NIVELIN BACHELOR DHE MASTER	17
3.1 Procedurat e diplomimit bachelor	17
3.2 Procedurat e diplomimit në master	18
IV. KODI ETIK	19
4.1 Të drejtat dhe obligimet e studentit	20
Detyrat e studentëve janë:	20
4.2 Sjellja e studentëve brenda Institucionit	21
V.TEKNOLOGJIA INFORMATIVE E IT-SË DHE SHËRBIMET E DMIS	22
5.1 Procedurat e qasjes së studentëve në DMIS	22
5.2 Opsionet e sistemit të DMIS-së për studentë dhe përmbajtja e tyre	23
BIBLOTEKA E KOLEGJIT DARDANIA	24
SALLA E LEXIMIT	25
UNIONI STUDENTOR	26
KONTRIBUTET E KOLEGJIT DARDANIA NË KOMUNITET	28
STUDENTË TË DIPLOMUAR - ALUMNI	29

FJALA E REKTORES

Në emër të menaxhmentit, stafit akademik të Kolegjit Dardania, dhe në emrin tim personal, është kënaqësi e veçantë të publikohet Doracaku për studentë. Ky doracak do të kontribuojë fuqishëm për informim saktë për shërbimet që ofron kolegji.

Doracaku është vazhdimësi i punës së përgjegjshme që po e bëjmë në organizmat përkatës të Kolegjit Dardania. Ky doracak është një dokument në të cilin mbështetet Kolegji Dardania për ndërtimin e mëtejshëm, zhvillimin dhe promovimin e punës akademike, shkencore, kërkimore dhe në veçanti avancimin e të mësuarit dhe të nxënit të studentëve.

Doracaku do të ofrojë udhëzime të detajuara për ndërmarrjen e veprimeve të përshtatshme, hartimin e politikave të pasura e prosperuese dhe zhvillimin e instrumenteve përkatëse si institucion i arsimit të lartë, i cili është i përqendruar në aftësimin e të rinjve për tregun e punës, si dhe në plotësimin e nevojave të gjithë shoqërisë.

Me respekt,

Prof. Dr. Gjyldane Mulla, Rektore

LOKACIONI I KOLEGJIT DARDANIA

Harta dhe udhëzimet


Kolegji Dardania ndodhet në qendër të Kryeqytetit të Kosovës, në Rrugën Ibrahim Lutfiu, numër 93, Prishtinë 10000, Kosovë.

✉ e-mail adresa e kontaktit; info@kolegjidardania.com

✉ e-mail adresa; administrata@kolegjidardania.com

☎ Numri kontaktues; +38344 249 100; +38344 636 359

🌐 Website: www.kolegjidardania.com



HISTORIKU

Veprimtaria e Institucionit të Kolegjit Dardania si Universitet formalisht - ligjor, një institucion privat universitar, ka filluar ligjërisht me aktin e licencimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me certifikatën nr. 898/02-1 datë 01.12.2004 për vitet akademike 2004-2007. Në vazhdimin e veprimtarisë së tij, Kolegji është riakredituar me vendimin nr.583/02-1 të dates 09.05.2007, për vitet akademike 2007 – 2011 si Universiteti Dardania. Mirëpo, me rastin e riakreditimit institucional për programe specifike të nivelit BA dhe MA për vitet 2009 dhe në vijim, nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe MASHT është akredituar dhe licencuar si Bartës Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) si Kolegji Dardania. Që nga viti 2004, Kolegji Dardania ka ofruar programe studimi për nivelin Bachelor dhe Master bazuar në Sistemin Evropian të Deklaratës së Bolonjës.

Kolegji Dardania ofron shërbime cilësore dhe pozicion të favorshëm për të gjithë, meqenëse selia dhe kampusi i tij ndodhen në qendër të kryeqytetit të Republikës së Kosovës. Misioni i Kolegjit Dardania fokusohet në arsim cilësor për të gjithë dhe shërbim ndaj komunitetit. Që nga themelimi i tij në vitin 2004, Kolegji Dardania ka rivendosur dhe ripërcaktuar kufijtë e mendimit intelektual dhe krijues, duke u afirmuar si një qendër e njohur akademike. Qasja jonë serioze dhe akademike ndaj arsimit dhe fushave të studimit është e përkushtuar në edukimin e mendjeve krijuese.

Në Kolegjin Dardania, studentët gëzojnë liri akademike për të ndërtuar rrugët e tyre unike dhe individuale në një botë komplekse dhe dinamike.

VIZIONI



VISION

Vizioni i Kolegjit është të vazhdojë të ruajë, zhvillojë më tej dhe forcojë pozicionin dhe reputacionin e tij si një nga institucionet e besueshme të arsimit të lartë për studime, praktikë dhe kërkim në shkencat shoqërore, i krahasueshëm me institucionet e besueshme në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Misioni dhe Vizioni i Kolegjit Dardania është rishikuar gjatë zbatimit të rekomandimeve të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës në vitet 2012, 2016, 2019 dhe 2024, gjatë rishikimit të Planit Strategjik për Zhvillimin e Kolegjit për periudhën 2025-2029.

MISIONI



MISSION

Kolegji Dardania është një institucion privat i arsimit të lartë që ofron arsim cilësor në fushën e shkencave shoqërore: shkenca politike, ekonomi dhe psikologji. Përmes aktivitetit të tij akademik dhe shkencor, Kolegji Dardania ofron mundësi për zhvillim akademik dhe profesional, kualifikim praktik dhe shërbim në komunitet që kontribuon në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë kosovare.

Përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, Kolegji ndërton staf të kualifikuar dhe të aftë profesionalisht për të kontribuar në avancimin e politikave publike, zhvillimin ekonomik dhe rritjen e cilësisë së jetës shoqërore dhe kulturore në Kosovë.

Kolegji ofron studime multidisiplinare që përparojnë njohuritë e studentëve dhe aftësitë e tyre për t'u bërë nxënës gjatë gjithë jetës.

Si pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, në programet e tij Kolegji zbaton standardet e përbashkëta të Deklaratës së Bolonjës, duke nxitur bashkëpunim intensiv me institucionet e arsimit të lartë në Bashkimin Evropian dhe më gjerë.

OBJEKTIVAT

- ❖ *Të ofrojë arsim cilësor në fushën e shkencave sociale, duke përfshirë shkencat politike, ekonominë dhe psikologjinë, në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë;*



- ❖ *Të zhvillojë studentët në aspektin akademik dhe t'i kualifikojë ata në aspektin profesional, duke i përgatitur për tregun e punës dhe sfidat e shoqërisë bashkëkohore në nivel lokal dhe ndërkombëtar;*
- ❖ *Të ngritë kapacitetet kërkimore shkencore, me qëllim kontributin në avancimin e njohurive dhe zgjidhjen e problemeve sociale përmes kërkimit të aplikuar;*
- ❖ *T'i edukojë studentëve për të nxënë gjatë gjithë jetës duke zbatuar një qasje ndërdisiplinore dhe metodologji bashkëkohore të mësimdhënies;*
- ❖ *Të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë kosovare përmes arsimimit të kuadrove përgjegjëse dhe aktive në jetën publike dhe institucionale;*
- ❖ *Të rrisë cilësinë e jetës shoqërore dhe kulturore në Kosovë përmes arsimimit të kuadrove, të aftë për të ndikuar në zhvillimin e politikave të sistemit publik dhe ekonomik;*
- ❖ *Të zbatojë standardet e Deklaratës së Bolonjës duke siguruar krahasueshmëri, transparencë dhe bashkëpunim me institucionet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë;*
- ❖ *Të inkurajojë bashkëpunimin akademik ndërkombëtar përmes partneriteteve me universitete dhe institucione në BE dhe më gjerë.*

STUDIMET NË KOLEGJIN DARDANIA

Studimet në Kolegj përcaktohen në bazë të programeve të studimit, ndërsa përmbajtja e programeve të studimit për mësimdhënie përcaktohet me rregulloret e përgatitura nga Këshilli Akademik i programit përkatës dhe miratohet nga Senati. Kolegji ofron këto lloj studime:

Studime themelore- studimet bachelor (BA)

Studime pasdiplomike - studimet master (MA)

Studimet themelore zgjasin së paku tre vite, gjatë të cilave studentët fitojnë përgatitje të lartë akademike dhe, pasi të diplomohen, marrin diplomën Bachelor në fushën përkatëse të studimeve. Studimet post diplomike, varësisht nga numri i kredive të fituara nga programet paraprake të nivelit BA, zgjasin një vjet (60 ECTS), përkatësisht dy vjet 120 (ECTS). Gjatë studimeve studentët fitojnë përgatitjen e lartë akademike si dhe pas diplomimit marrin titullin Master (MA) nga fushat përkatëse të studimeve.

Në programet e studimeve Bachelor

Studentët potencialë në programet tona Bachelor janë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, provimin e maturës shtetërore, si dhe kanë arritur rezultate të suksesshme në shkollën e mesme.

Në programet e studimeve post diplomike - Master

Në studime post diplomike-Master, mund të regjistrohen kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet themelore Bachelor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet themelore Bachelor jashtë Kosovës. Në raste të tilla kandidati duhet të sjell dëshminë (vendimin), mbi akreditimin e institucionit në të cilën ka mbaruar

Të gjithë studentët e regjistruar në programet tona të studimit trajtohen dhe respektohen në mënyrë të barabartë, dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen veçanërisht në Statutin dhe rregulloret e Kolegjit Dardania.

I. VIJUESHMËRIA E STUDIMEVE

Në Kolegj veprimtarinë mësimore, shkencore, artistike dhe profesionale e zhvillon personeli akademik, kualifikimi i të cilëve përcaktohet me tituj shkencor - mësimor dhe me tituj të bashkëpunëtorëve. Studimet mund të vijohen me shkëputje nga puna dhe pa shkëputje nga puna, ashtu siq parashihet në Statutin e Kolegjit Dardania dhe me rregulloret e tij.

1.1 Plani dhe programi mësimor

Plani dhe programi studimor përmban lëndët me status si të detyrueshme dhe me statusin e lëndëve-kurseve me zgjedhje, të cilat rregullohen më hollësisht me Rregulloren e studimeve të nivelit BA dhe MA të Kolegjit. Kolegji kujdeset që planprogramet të jenë sa më bashkëkohore, në harmoni me nevojat e tregut të punës, mbështetur në Kornizën Evropiane të kualifikimeve dhe në Kornizën Kosovare të kualifikimeve. Programet e studimit iu përshtaten mundësive dhe nevojave të studentit. Çdo mësimdhënës është i obliguar që në fillim të vitit akademik t'i dorëzojë syllabuset e kurseve, dhe t'i njoftojë studentët se ku mund të gjejnë literaturën bazike (të obliguar dhe të preferuar). Në syllabus përfshihet edhe valorizimi i kontributit të ngarkesës së studentit si dhe procedurat e vlerësimit.

Viti akademik fillon me 10 tetor të vitit vijues dhe përfundon me 10 tetor të vitit të ardhshëm. Mësimi në kolegj realizohet në semestra (semestri dimëror prej 10.10 deri më 25.01 dhe semestri veror prej 25.02 deri më 10.06 të vitit vijues).

Stafi akademik (profesorët dhe asistentët) mbajnë evidencë të vijueshmërisë së studentëve në orën e ligjëratave dhe të ushtrimeve. Ligjëruesit para fillimit të orës mësimore nga zyrtarët e administratës pajisen me Formularët e pranisë së studentëve. Ligjëruesi në fillim të orës mësimore kërkon nga studentët të plotësojnë formularët dhe ti firmosin ato, si dëshmi për praninë tyre në orë, sepse vijueshmëria e studentit është kriter vlerësimi mbi bazën e të cilit fitohet numër i caktuar i pikëve të vlerësimit. Formularët e plotësuar dorëzohen në zyrën përkatëse pas përfundimit të orëve të realizuara dhe evidentohet në regjistrin përkatës.

Në Kolegjin Dardania mësimdhënësit aplikojnë një mori të metodologjive me qëllim të zhvillimit të aftësive dhe praktikave që mundësojnë të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Mësimdhënia e avancuar



Është një ndër metodologjitë që zbatohet përmes të nxënit ndërveprues, ku studentët vazhdimisht janë në qendër të procesit të nxënies, dukr aplikuar shkathtësitë hulumtuese, teknikat që nxisin të menduarit kritik dhe krijues, si dhe zhvillimi i të menduarit analitik.

Mbështetja e vazhdueshme e studentëve



Është një metodë tjetër e cila aplikohet nga mësimdhënësit e kolegjit, me qëllim të mentorimit të vazhdueshëm të punës së studentëve, duke u ofruar këshilla të vazhdueshme rreth realizimit të detyrave, prezantimeve, dhe hulumtimeve gjatë procesit të punës së tyre.

Punë e avancuar kërkimore dhe shkencore



Mësimdhënësit e kolegjit angazhojnë studentët në përgatitjen e punimeve shkencore me qëllim të zhvillimit të shkathtësive kërkimore shkencore.

Gjatë përgatitjes së punimeve mësimdhënësit vazhdimisht bashkëpunojnë me studentë, duke ofruar informata dhe këshilla relevante lidhur me përgatitjen e punimit.

Integrimi dhe mësimdhënia ndërkurikulare



Me integrimin e metodave ndërkurikulare, studentët zhvillojnë shkathtësi hulumtuese, krahasuese dhe rrisin aftësitë e të menduarit kritik. Mësimdhënësit paraprakisht përzgjedhin temat nga syllabusi dhe kërkojnë nga studentët të bëjnë integrimin e temave të përzgjedhura në disa fusha tjera.

Puna me studentë në qendër



Mësimdhënësit aplikojnë metodën puna me studentin në qendër me qëllim të përvetësimit të njohurive dhe aftësive të tyre, kështu që studentët të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të pavarur. Kjo metodë e mësimdhënies zhvendos fokusin e mësimimit nga mësimdhënësi tek studenti.

Mësimdhënia e diferencuar



Është një mënyrë tjetër e punës e cila aplikohet nga mësimdhënësit e kolegjit. Mësimdhënia e diferencuar paraqet zhvillimin dhe përshtatjen e mësimimit sipas gjendjes, nivelit, aftësive, gatishmërisë dhe mënyrave të të mësuarit të studentëve, duke filluar nga parapërgatitja, planifikimi dhe realizimi i saj përmes metodave të shumta dhe teknikave, deri te bashkëpunimet grupore të studentëve.

1.2 Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik të studentit

Mësimdhënësit përdorin një gamë metodash të vlerësimit për të përcaktuar suksesin akademik të studentëve, ku më poshtë janë të paraqitura disa nga metodat e vlerësimit:

- Provimi;
- Kolokviumi;
- Punim seminarik;
- Vijueshmëria, angazhimi dhe prezantime;
- Praktika seminarike;
- Testi praktik gjatë ushtrimeve;
- Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë teorike e artistike.

Provimet nga Kolegji Dardania mund të organizohen:

- Me gojë;
- Me shkrim;
- Me gojë dhe me shkrim.

Studentët në kolegji vlerësohen periodikisht gjatë gjithë procesit mësimor, ndërsa nota përfundimtare përcaktohet me provimin përfundimtar. Suksesi i studentëve shprehet nga nota 5 (pesë) deri në notën 10 (dhjetë).

Nr.	Nota	Përshkrimi	
1	Dhjetë	10-A	Shkëlqyeshëm
2	Nëntë	9-B	Shumë mirë
3	Tetë	8-C	Mirë
4	Shtatë	7-D	Kënaqshëm
5	Gjashtë	6-E	Mjaftueshëm
6	Pesë	5-F	Dobët

Mënyra e përcaktimit të dijes dhe e dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus. Oraret e afateve të provimeve, ku janë të përfshira oraret ditore, shpallen në fillim të vitit akademik. Afatet e provimeve janë: afati i janarit, afati i prillit, afati i qershorit, afati i shtatorit dhe afati i nëntorit. Orari i provimeve shfaqet në fillim të vitit për të gjitha afatet, afatet me të hollësishme rregullohen me Rregulloret e Kolegjit Dardania.

1.3 Pakënaqësitë ndaj notës

Studenti ka të drejtë t'i parashtrij ankesë me shkrim Dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrihet brenda dy (2) ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:

- për provimin me shkrim parashtrihet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
- për provimin me gojë parashtrihet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
- për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:

Pas pranimit me kohë të ankesës, Dekani i njësisë akademike formon Komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.

Në rast se përsëritet provimi gojazi, vlerësimi nga Komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar Komisioni. Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga Komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar Komisioni. Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të Komisionit. Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentëve ruhen se paku një (1) deri në dy (2) vite.

Studenti humb statutin e studentit:

- Kur përfundon studimet;
- Kur ç'regjistrohet;
- Kur nuk regjistrohet në vitin vijues ose në të njëjtin vit të studimeve;
- Me vendim nga proceduara disiplinore;
- Kur nuk i kryen studimet në afatin e përcaktuar;
- Me vdekjen e studentit;
- Në rast të tjera të përcaktuara me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret përkatëse të Kolegjit.

II. PROGRESI AKADEMIK

Studenti ka të drejtë ta regjistrojë vitin e dytë të studimeve, nëse i ka dhënë 70% të provimeve, nga numri i përgjithshëm i provimeve, ose t'i ketë fituara 41 kredi nga lëndët mësimore, të vitit të parë të studimeve.

Vitin e tretë të studimeve, studenti mund ta regjistrojë, nëse i ka kryer 35% të provimeve, përkatësisht nëse ka fituar 20 kredi, nga numri i përgjithshëm i kredive të lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.

Vitin e katërt, studenti mund ta regjistrojë, nëse ka dhënë 30% të provimeve nga numri i përgjithshëm, përkatësisht, nëse ka fituar 18 kredi, nga lëndët mësimore të vitit të tretë të studimeve.

Studenti nuk mund të hyj në provime të vitit të dytë, pa i përfunduar provimet e vitit të parë; gjithashtu student i vitit të dytë nuk mund të hyjë në provimet e vitit të tretë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të dytë.

Studenti duhet t'i mbaroj studimet themelore dhe studimet postdiplomike akademike brenda një periudhe që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studimet që i ka regjistruar, me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendos Këshilli mësimor- shkencor.

Përfaqësimi i studentëve

Studentët e Kolegjit Dardania janë të përfaqësuar në të gjitha organet këshillimore dhe vendimmarrëse ekzekutive në raportin 1 me katër (1:4). Mekanizmi i zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve bazohet në procedurën e zgjedhjeve demokratike, e cila është transparent dhe jo diskriminuese dhe është plotësisht në përputhje me Statutin e Kolegjit Dardania, përkatësisht me Rregulloren për zgjedhjet studentore në Kolegj.

2.1 Bursa dhe mbështetje financiare për studentë

Studentët që studiojnë në Kolegjin Dardania gjatë studimeve të tyre kanë mundësi që të përfitojnë përkrahje financiare, si stimulim për suksesin e treguar gjatë studimeve.

Kolegji ndanë bursa për studentët të nivelit Bachelor (BA) dhe Master (MA).

Kategoritë e bursave janë:

Bursa të plota - për studentë shembullor

Bursën e plotë e fitojnë kandidatët të cilët përfundojnë me sukses shembullor vitin e I- rë dhe regjistrojnë në afatë vitin e II-të, për studentët e nivelit Bachelor dhe Master. Kriteret e bursës për studentë shembullor janë dhënë në detale te Rregullorja për Bursa dhe Mbështetja Financiare. Studentët të cilët plotësojnë kushtet e kërkuara përfitojnë bursë një vjeçare.

Mbështetja financiare

Mbështetje financiare fitojnë studentët e nivelit Bachelor dhe Master të cilët i përkasin këtyre kategorive: familje të viktimave - të luftës dhe veteran, familje me ndihmë sociale, për studentët e të njëjtës familje.

Studentët bursistë dhe përfituesit e mbështetjes financiare e humbin të drejtën e bursës ose të mbështetjes financiare në rastet kur nuk i respektojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Bursa dhe Mbështetje Financiare.

III. PROCEDURAT E DIPLOMIT PËR NIVELIN BACHELOR DHE MASTER

3.1 Procedurat e diplomimit bachelor

Pas përfundimit të suksesshëm të provimeve gjatë studimeve, studenti ka të drejtë të fillojë me procedurat e diplomimit të cilat janë të specifikuara përmes Rregullores për studime themelore.

Studenti ka të drejtë të parashtoj kërkesë me shkrim për lejimin e tezës së punimit të diplomës dhe caktimit të mentorit, pasi të ketë kryer të gjitha obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor. Mentor potencial i studentit është mësimdhënësi sipas fushës së ekspertizës me të cilin korrespondon tema e propozuar. Në provimin përfundimtar (diploma), studenti duhet të tregojë dituri dhe të prezantojë aftësi teorike, që ka arritur gjatë kohës së studimeve, në përvetësimin e temës së dhënë, duke vërtetuar se temën e ka punuar vet mbështetur në metodologjinë përkatëse të hulumtimit, që i përgjigjen punimit, se e njeh literaturën dhe di ta përdorë atë në mënyrë profesionale dhe të pavarur. Mbrojtja e suksesshme e punimit të diplomës së studimeve Bachelor nënkupton respektimin e rekomandimeve të parapara me Doracakun për hartimin e punimit të Diplomës Bachelor.

Mbrojtja e temës së diplomës është publike dhe zhvillohet para komisionit të përbërë nga tre anëtar duke respektuar Rregulloren. Hapat të cilët duhet të ndiqen për mbrojtjen e punimit të diplomës janë: Kërkesa për mbrojtjen e temës së diplomës bëhet në Administratën e Kolegjit Dardania, te zyrtari i autorizuar;

- *Kërkesa plotësohet me të gjitha të dhënat për studentin, që paraqitet për mbrojtjen e provimit përfundimtar;*
- *Krahas kërkesës për paraqitjen e provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe: Indeksën dhe ID kartelën. Së bashku me dokumentet e mësipërme dorëzohet edhe projekt-propozimi i temës.*

Detajet tjera për procedurat e diplomimit i gjeni në Rregulloren për Studime Bachelor dhe në Udhëzuesin për punim diplome bachelor.

Studenti i diplomuar në Kolegjin Dardania merr titullin “Bachelor” në programet e akredituara dhe licensuara sipas njësive akademike.

3.2 Procedurat e diplomimit master

Studimet master në Kolegjin Dardania përfundojnë me mbrojtjen e punimit master, në pajtim me programin e studimeve. Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me plan dhe program mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marr temën master. Studenti ka të drejtë të parashtoj kërkesë për lejimin e tezës së masterit pasi të ketë kryer të gjitha obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor. Si mentor potencial i studentit është mësimdhënësi në konsultim me të cilin studentit është përcaktuar për temën e punimit të masterit.

Punimi master punohet individualisht nga studentit duke vërtetuar se aftësitë teorike dhe praktike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve kërkimore në fushën shkencorë-kërkimore për të cilën është përcaktuar studentit.

Propozimi me shkrim për lejimin e temës për punimin master duhet të përmbajë: Arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin e studimit, përmbledhjen e literaturës së shqyrtuar, pyetjet e hulumtimit dhe hipotezën/at, rezultatet e pritura të studimit dhe referencat e literaturës së shqyrtuar.

Teza master në programet e Kolegjit Dardania orientimisht duhet të përmbajë 12.000 deri në 15.000 fjalë. Referencat, shënimet në fund të faqes nuk përfshihen në këtë përlllogaritje. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthej në vete fushën kërkimoro-shkencore sipas programit studimor përkatës. Kërkesa e kandidatit për punimin e tezës së masterit duhet të bëhet me shkrim dhe të dorëzohet projekt-propozimi në Administratën e Kolegjit Dardania. Parashtruesi i kërkesës (studenti) merr vendim me shkrim për lejimin e temës së propozuar, pas të cilit vendim, kandidati në konsultim me mentorin mund të fillojë të përgadis tezën e temës së masterit.

Studimet master përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e tezës së masterit para komisionit përkatës, në pajtim me programin e studimeve nga i cili fiton 120 ECTS.

Detajet tjera për procedurat e diplomimit i gjeni në Rregulloren për Studime Master dhe në Udhëzuesin për punim diplome Master.

IV.KODI ETIK

Kodi Etik përcakton standarde themelore të sjelljes për tërë komunitetin e Kolegjit Dardania. Ky kod i aplikohet stafit akademik, studentëve dhe stafit administrativ për të promovuar marrëdhënie të mira ndërpersonale brenda komunitetit. Vlerat themelore të Kolegjit Dardania janë: përsosmëria, ndershmëria, autonomia, liria në mësimdhënie dhe hulumtime shkencore, me të cilat arrihet respektimi i integritetit personal, humanizmi i raporteve ndërnjerëzore, drejtësia, barazia dhe vërtetësia si vlerë më e lartë.

Qëllimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies në Kolegjin Dardania nga ana e stafit akademik është përhapja e njohurive, nxitja e mendimit kreativ, kritik dhe të përgjegjshëm. Ndërsa aktivitetet kërkimore shkencore bazohen në lirinë e hulumtimit, ndershmërinë në kërkim dhe integritetin personal në hulumtime. Ndershmëria në hulumtime shkencore përfshin respektimin e vazhdueshëm të autorësisë dhe njohjen e saktë të arritjeve kërkimore shkencore të studimeve të tjera, duke i cituar ato.

Kolegji Dardania, për ngritjen e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe shmangien e plagjiaturës, për momentin është duke aplikuar programin Turnitin, ky program mundëson kontrollin e origjinalitetit dhe parandalimit të plagjiaturës të punimeve të studentëve. Sa i përket verifikimit të punimeve dhe publikimeve shkencore të stafit akademik në bazë të vendimit të MASHTI-it më 15.08.2022, të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë të Kosovës obligohen që me rastin e deklarimit të stafit akademik në platformën e-akreditimi të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) të bëjnë ngarkimin e disertacionit të doktoratës dhe të publikimeve në revistat e indeksuara. Përgjegjës për respektimin e rekomandimeve të parapara me Kodin e Etikës të Kolegjit Dardania është Komiteti i Etikës i emëruar nga Senati i Kolegjit, për zgjedhjen e çdo problemi që lind për shkak të shkeljes së mundshme të Kodit të Etikës.

Kodi i Etikës parashikon masat disiplinore që shqiptohen në rastet e shkeljes së standardeve nga ana e komunitetit, të cilët kanë të bëjnë me menaxhimin, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe administrimin. Në varësi të shkeljes së normave etike Komisioni Disiplinor vendos për masat disiplinore si në vijim: paralajmërim, afat prove, dëmshpërblim, përjashtim (shkëputja e kontratave të anëtarëve të komunitetit).

4.1 Të drejtat dhe obligimet e studentëve

- Të ndjekin të gjithë ligjëratat, seminarët dhe të gjitha aktivitetet e tjera mësimore të organizuara nga kurset e tyre sipas nivelit të studimeve dhe të ndjekin proceset të tjera të organizuara mësimore;
- Të shfrytëzojnë mjedisin e bibliotekës, internetin dhe shërbimet e tjera studentore në kampus;
- Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore në të cilat mund të anëtarësohen të gjithë studentët;
- Të marrin pjesë në zgjedhjet e posteve studentore në organet e Kolegjit;
- Të jenë pjesë e organizatës/ve studentore, në varësi të përcaktimit të ligjeve dhe akteve të Kolegjit, statutit dhe rregulloreve;
- Në fund të vitit akademik secili mund të pajiset me Certifikatë të notave;
- Në përfundim të studimeve të pajisen me dokumentacionin relevant;
- Studentët kanë të drejtë të ankohet për cilësinë e ligjërimit ose për kushtet që ofron Kolegji; Ankesat fillimisht i dorëzohen dekanit ose personit përgjegjës;
- Interesat e studentit do të përfaqësohen në kuadër të Kolegjit me këto organe;
 - I. Parlamenti i studentëve të Kolegjit;
 - II. Këshilli i studentëve të njësisë akademike;
 - III. Senatin e Kolegjit.
- Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë dhe të zgjedhin anëtarët për parlamentin e studentëve, këshillat e studentëve të programeve dhe përfaqësuesit e tyre në trupat e Kolegjit (Këshillat e njësive akademike dhe Senatin e Kolegjit) në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo 3 vite.

Detyrat e studentëve janë:

- Të repektojnë rregullat e hartuara nga Kolegji;
- Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe studentëve të tjerë;
- T'i kushtojnë vëmendjen e plotë studimeve dhe të marrin pjesë në aktivitete akademike;
- Të paguajnë pagesat dhe tarifën që janë të përcaktuara me kontratë.

4.2 Sjellja e studentëve brenda Institucionit

Studentët në ambientet e Kolegjin Dardania duhet:


- *Të zbatojnë orarin e mësimit dhe t'u përmbahen rregullave të parapara në Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Dardania;*
- *Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet e institucionit, e që nënkupton një veshje të përshtatshme sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes;*
- *Të respektojnë personelin akademik, ndihmës mësues dhe shkencor, personelin administrativ, kolegët dhe rregullat e mësimit;*
- *T'u drejtohen personelit akademik dhe atij administrativ në vetën e dytë shumës si dhe me titujt e plotë akademik përkatës;*
- *Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese ose ngacmuese ndaj personelit akademik ose studentëve të tjerë, në mjediset e institucionit;*
- *Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga rregullat e përcaktuara sipas Kodit Etik dhe rregulloreve përkatëse;*
- *Të mos konsumojnë pije alkoolike ose duhan në ambientet e institucionit;*
- *Të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit në auditor;*
- *Të mbajnë me vete gjatë procesit mësimor kartën e identitetit ose ID-kartelën e studentit të dhënë nga Kolegji Dardania dhe t'i paraqesin ose t'i dorëzojnë atë sipas kërkesës së anëtarëve të stafit akademik ose administrativ të Kolegjit Dardania.*

V.TEKNOLOGJIA INFORMATIVE E IT-SË DHE SHËRBIMET E DMIS

Kolegji Dardania i kushton rëndësi të veçantë shërbimeve ndaj studentëve. Studentët aktual posedojnë të drejtën që t'i përdorin të gjitha shërbimet e ofruara nga institucioni. Të gjithë studentët aktual pajisen me ID studentore nga kolegji, kanë e-mail'in e tyre personal me domain të kolegjit, si dhe qasje në DMIS ku ata mund të njoftohen me të gjitha të rejat nga administrata e kolegjit si dhe rreth pasqyrave të tyre financiare, rezultateve nga testet dhe provimet, si dhe rezultatet nga punimet e tjera të tyre.

5.1 Procedurat e qasjes së studentëve në DMIS

Studentët mund të qasen në sistemin e **DMIS**, me ndihmën e e-mail adresave personale. Klikohet te qasja dhe më pas hapet dritarja si më poshtë, ku do të jepni të dhënat për qasje të cilat do të njoftoheni me rastin e marrjes së **ID** kartelës studentore nga administrata e kolegjit.



Hapësira ku vendoset e-maili i studentit

Hapësira ku vendoset fjalëkalimi i studentit

Qasja

5.2 Opsionet e sistemit të DMIS-së për studentë dhe përmbajtja e tyre



Lëndët, ka dy nënmeny për regjistrimin e lëndëve, e para është regjistrimi i lëndëve obligative dhe e dyta regjistrimi i lëndëve zgjedhore për çdo semestër;



Fletëparaqitjet, jep mundësin e paraqitjes së provimeve për afat të caktuar dhe temës së diplomës, si dhe mund të shikohen rezultatet e provimeve për ato lëndë të cilat janë paraqitur nga student;



Transkripta e notave, është opsioni ku studentët njoftohen rreth notave që i posedojnë. Ata mund ta shkarkojnë transkriptën dhe pas shkarkimit duhet ta sjellin në administratën e kolegjit për vulosje.



Njoftimet, është opsioni ku vijnë të gjitha njoftimet për hapje të sistemit për paraqitje të provimeve, të afateve për diplomim dhe njoftimet tjera të cilat i ngarkojnë profesorët, Dekanët e njësive akademike etj;



Oraret, rubrika e orareve mundëson që studentët të njoftohen rreth orarit të ligjëratave, orarit mësimor, provimeve, afateve të provimeve, takimeve me mësimdhënësit etj;



Shkarko, është opsioni ku studentët mund të shkarkojnë rezultatet, materialet mësimore ligjërata, literatura, ushtrime dhe syllabuset;



Pagesat, kjo pjesë përmban opsionin e njoftimit të studentëve rreth pagesave për studime.

BIBLIOTEKA E KOLEGJIT DARDANIA

Kolegji Dardania posedon bibliotekën fizike e cila përfshinë katin e 3 dhe katin e 4 të hapësirave të institucionit tonë. Përveç bibliotekës fizike, studentët kanë mundësinë që të qasen edhe në bibliotekën elektronike.

Biblioteka është e pajisur me literaturën më të re dhe moderne, e cila është në dispozicion të studentëve në çdo kohë. Biblioteka e Kolegjit Dardania i përmbush në tërësi nevojat e studentëve për libra, tekste dhe literaturë si për lëndët obligative ashtu edhe për lëndët zgjedhore të cilat ligjërohen në programet e studimit të ofruara.



Biblioteka e Kolegjit Dardania ka stokun e vet të librave në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze sipas disiplinave në planprogramet e studimeve dhe përfshinë dy salla leximi që janë në dispozicion të studentëve. Biblioteka ka hapësirën e vet të leximit, hapësirën e punës në grupe dhe kompjuterët që mund të përdoren nga studentët. Përveç bibliotekës fizike, Kolegji Dardania u ka siguruar studentëve qasje në bibliotekat elektronike.

Kolegji Dardania është pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës që vepron brenda Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kolegji Dardania ka siguruar qasje në dhjetë baza të të dhënave të revistave elektronike ELBSCO duke u bërë pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës.



SALLA E LEXIMIT

Kolegji Dardania posedon sallën e leximit, e cila është e pajisur me pajisje teknologjike që u mundësojnë studentëve të shfrytëzojnë bibliotekën online, të realizojnë hulumtime të shumta për punime hulumtuese dhe shkencore, si dhe për përgatitjen e projekteve me tematika profesionale.



Sallat e leximit shfrytëzohen nga studentët, stafi akademik, stafi i Zyrës së Hulumtimit, Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie dhe Zyrëtarët e Zyrës për Orientim të Karrierës, etj. Të gjitha njësitë unike të librave, nuk dalin jashtë ambienteve të sallës së leximit dhe bibliotekës, ato janë vetëm për përdorim në ambientet e brendshme të Kolegjit.

Salla e leximit posedon edhe hapësira, ku studentët mund ta zhvillojnë punën grupore dhe punën në dyshe.



UNIONI STUDENTOR

Unioni Studentor i Kolegjit Dardania është organi përfaqësues për studentët e Kolegjit Dardania, i konstituuar që nga themelimi i Kolegjit Dardania në vitin 2004. Unioni Studentor është i përkushtuar për t'ju ndihmuar studentëve të përfitojnë sa më shumë nga Kolegji Dardania. Unioni Studentor mbështet organizimet studentore, duke ofruar një platformë për aktivitete të shumta si klube debati, iniciativa për socializim, organizimin e evenimenteve kulturore dhe programe vullnetarizmi. Këto aktivitete synojnë të përmirësojnë zhvillimin akademik dhe personal të studentëve, të inkurajojnë ndërveprimin social dhe kulturor dhe të rrisin ndjenjën e përgjegjësisë dhe përfshirjes qytetare brenda komunitetit universitar dhe më gjërë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Unionit Studentor debatojnë, llobojnë në emër të studentëve të Kolegjit Dardania.



Anesa Gashi, është studente në programin Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, njëkohësisht Anesa përfaqëson Unionin Studentor brenda Kolegjit Dardania. Në kuadër të Unionit Studentor është themeluar Klubi i Vullnetarizmit, i cili përfaqësohet nga një grup i studentëve të programeve Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale si dhe Shkenca Politike dhe Administrim Publik.

Anëtarët e Klubit të Vullnetarizmit



AKTIVITETET DHE PROJEKTET TË REALIZUARA NGA ZYRA PËR ORIENTIM TË KARRIERËS NË BASHKËPUNIM ME UNIONIN STUDENTOR



Sesion informues për studentë dhe të diplomuar “Zhvillimi i Shkathtësive për Punësim”.

Zyra për Orientim të Karrierës në kuadër të Kolegjit Dardania në bashkëpunim me GIZ DIMAK, realizuan sesionin informues për studentët me temë “Përgatitje për tregun e punës dhe punësimi”.



Kolegjit Dardania në bashkëpunim me American Advising Center, kanë zhvilluar sesionin informues në lidhje me mundësitë e studimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



KONTRIBUTET E KOLEGJIT DARDANIA NË KOMUNITET

Kolegji Dardania, vazhdon të ofroj shërbime për komunitet nëpërmjet projekteve të realizuara nga studentët në bashkëpunim me Zyrën për Orientim të Karrierës. Projektet e realizuara nga studentët i kontribuojnë fushave të ndryshme sociale, arsimore dhe humanitare.



“Libri im”, është një nga projektet e cila është realizuar nga studentët e programeve Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale dhe Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale.

Projektet “Ndërmarrësia dhe Karriera” dhe “Si ta zhvillojmë një Start-up” janë dy projekte me nga 4 - module që janë realizuar me nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Prishtinës.



Çertifikimi

Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimeve dhe punëtorive, Kolegji Dardania shërblen studentët dhe nxënësit të shkollave të mesme me çertifikata.

STUDENTË TË DIPLOMUAR - ALUMNI

Në rrjetin Alumni përfshihen studentë të diplomuar nga Kolegji Dardania. Përmes takimeve të organizuara nga Zyra për Orientim të Karrierës studentët të diplomuar janë pjesëmarrës në aktivitetet të shumta që organizohen nga kolegji. Qëllimi i bashkëpunimit të Zyrës për Orientim të Karrierës me studentë të diplomuar apo Alumni është forcimi i lidhjeve në mes të diplomuarve, profesorëve, bashkësisë më të gjërë akademike si dhe punëdhënësve. Në vitin 2023, është realizuar hulumtimi rreth punësimit të studentëve të diplomuar, ku janë vlerësuar shumë indikator që ndikojnë në performancën e punës së të diplomuarve. Më poshtë është paraqitur tabela e cila pasqyron përqindjen e studentëve të diplomuar të punësuar ndër vitet 2019/2024, dhe në bazë të rezultateve të fituara mesatarja e punësimit të diplomuarve figuron 75.16%.


Vitet	Të diplomuarit e punësuar
2019	71%
2020	74%
2021	73%
2022	68%
2023	85.9%
2024	79.1%



***Arbnore Duraku**, është një nga studentet e diplomuar në Kolegjin Dardania në programin Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale. Arbnorja është e punësuar në Apple Care – Geodis, në Pensylvania të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*




***Blend Zyrapi**, ka përfunduar studimet Bachelor në Programin “Shkenca Politike dhe Administrim Publik” në Kolegjin Dardania. Blendi është i punësuar si asistent hulumtues në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave – KIPRED.*



Arbenita Sopaj, studentja e Kolegjit Dardania e cila ka përfunduar studimet në programin “Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane”, kandidatja e vetme shqiptare për Doktoraturë “Diplomaci Japoneze” në Kobe University, Japoni.



Driton Demolli, ka studiur në programin “Shkenca Politike dhe Administrim Publik” në Kolegjin Dardania. Dritoni aktualisht punon në Ministrinë e Kulturës – Rinis dhe Sportit. Dituritë dhe grada akademike që e fitoi në Kolegjin Dardania i mundësuan atij punësim të rregullt në institucionet publike.



Mimoza Morina - Kelani, është e diplomuar në nivelin Bachelor dhe Master në Programin “Administrim Biznesi dhe Ekonomiks” në Kolegjin Dardania. Mimoza është e punësuar si Auditore në Zyra Kombëtare e Auditimit/National Audit Office.



***Fitore Misini**, ka përfundur studimet Bachelor dhe Master në Kolegjin Dardania ku tregoi sukses të shkëlqyer gjatë studimeve.*

Nga muaji mars deri në prill, Fitorja qëndroi në Amerikë në një program shkëmbimi të quajtur “International Leadership Visitor Program – IVLP” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për të marrë pjesë në këtë program, ajo u nominua nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.

Gjatë periudhës sa qëndroi atje, vizitoi Departamentin e Shtetit Amerikan, organizata të ndryshme, shkolla dhe shumë institucione kulturore. Ajo ishte pjesëmarrësja e vetme në këtë program nga Kosova. Përvoja e saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t’i shërbejë Fitores në punën e saj në American Corner Pristina.

